

**THIRRJE PËR AVOKAT**  
**PËR OFRIMIN E NDIHMËS LIGJORE FALAS PËR GRATË DHE VAJZAT E**  
**DËMTUARA NGA TËRMETI**

**Tiranë, më 10.03.2022.**

Qendra për Nisma Ligjore Qytetare në kuadrin e projektit “*Për rimëkëmbjen dhe rindërtimin pas tërmetit me ndjeshmëri gjinore*”, i cili zbatohet nga UN Women dhe mbështetet financiarisht nga Qeveria Suedeze përmes fondit të Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm të Kombeve të Bashkuara në Shqipëri kërkon të kontraktojë një avokat për të ofruar shërbimin e ndihmës juridike parësore dhe dytësore falas për çështje pronësore të grave dhe vajzave të dëmtuara nga tërmeti.

Preferohen avokatë me përvojë në ndjekjen e çështjeve pronësore të grave.

**Përshkrimi i detyrave**

Avokati/ja do të angazhohet për kryerjen e detyrave si më poshtë:

**Detyrat dhe përgjegjësitë:**

- Të ofrojë ndihmë juridike falas për gratë dhe familjet e dëmtuara nga tërmeti;
- Të ofrojë ndihmë juridike parësore dhe/ose dytësore për rastet e grave dhe vajzave të dëmtuara nga tërmeti. Në disa raste të veçanta duhet të ofrojë ndihmë juridike dytësore.
- Të ofrojë ndihmë juridike falas lidhur me: procedurat për posedimin dhe përvetësimin e shtëpive të reja ose pronave të tjera përfshirë tokën, përpilimin e kontratave në zyrat e noterisë, regjistrimin e pronës në Kadastrën Shtetërore, procedurat për legalizimin e ndërtesave informale të rindërtuara dhe regjistrimin nën emrin e të dy bashkëshortëve ose anëtarëve të tjerë të familjes që kanë të drejtë të përfshihen bazuar në legjislacionin, procedurat për korrigjimin e regjistrimeve të mëparshme të pronave të rindërtuara dhe probleme të tjera në lidhje me gëzimin e të drejtave pronësore të grave.
- Të informojë individët, në mënyrë të veçantë gratë dhe vajzat e dëmtuara nga tërmeti në lidhje me problematikat që kanë në lidhje me çështje pronësore, si dhe në lidhje me institucionet ku duhet të drejtohen për zgjidhjen e problematikave të tyre.
- Të ofrojë ndihmë juridike falas për gratë dhe anëtarët e komunitetit të zonave të prekura nga tërmeti lidhur mosmarrëveshjet e tjera që lidhen me familjen, duke përfshirë çështjet e zgjidhjes

së martesës dhe ndarjes së pasurisë së përbashkët, kujdestarinë e fëmijëve, detyrimin për ushqim si dhe zbatimin e vendimeve të gjykatave, lëshimin e urdhërave të mbrojtjes apo çështje të tjera.

-Të ofrojë ndihmë juridike parësore dhe/ose dytësore për rastet e grave dhe vajzave të dëmtuara nga tërmeti kryesisht me fokus zonat: Lezhë, Mirditë, Kurbin, Durrës, Shijak, Rrogozhinë, Kavajë, Tiranë, Vorë, Kamëz dhe nëse do të dalë e nevojshme edhe raste nga bashkitë e tjera që mbulon projekti, mund të mbështeten prej saj/tij.

-Të informojnë individët në lidhje me institucionet ku duhet të drejtohen për zgjidhjen e problemeve të tyre;

-Të bashkëpunojnë me avokatët/juristët e Qendrës për Nisma Ligjore Qytetare dhe stafin e projektit;

### **Periudha kohore:**

Detyrat dhe përgjegjësitë do të përmbushen për një periudhë të shkurtër nga lidhja e kontratës deri më 30 Qershor 2022.

### **Kualifikimet e kërkuara të kandidatëve:**

- Të këtë mbaruar studimet Bachelor në drejtësi; Studimet master ose ekuivalente me to janë të preferueshme.
- Të këtë të paktën 1 vit përvojë në informim, ndërgjegjësim e këshillim të qytetarëve si dhe në ofrimin e ndihmës ligjore për çështje pronësore të grave, familjare dhe mbrojtje nga dhuna në marrëdhëniet familjare ose forma të tjera të dhunës me bazë gjinore;
- Të këtë licencë avokati;
- Të njohë shumë mirë paketën microsoft office;
- Të jetë i/e motivuar në kryerjen e detyrave dhe përgjegjësi të caktuara.

Përvoja e mëparshme pranë organizatave të shoqërisë civile, është shumë e vlerësueshme.

### **Pagesa**

Fee për shërbimin e ofruar është 650 (Gjashtëqind e pesëdhjetë) Eur bruto në muaj.

### **Dokumentet:**

Kandidatët duhet të dorëzojnë dokumentacionin si vijon:

1. CV e kandidatit/es;
2. Kopje të Diplomës, e shoqëruar me kopje të listës së notave të studimeve Bachelor dhe/ose Master, ose ekuivalente me to;
3. Licensën e avokatit;
4. Çdo dokumentacion i nevojshëm që tregon kualifikimet e kandidatit/es dhe përvojat e mëparshme;
5. Dëshmi e penalitetit;

Dokumentacioni mund të dërgohet i skanuar në adresën e emailit avokatore2@yahoo.com ose, të depozitohet pranë zyrave të Qendrës për Nisma Ligjore me adresë Rruga “Vaso Pasha” Pll.12, Shk.1, Ap. 1 Tiranë.

**Afati i aplikimeve:**

**Afati i fundit i aplikimeve do të jetë data 16.03.2022, ora 16.00.**

Qendra për Nisma Ligjore Qytetare rezervon të drejtën që ta shtyjë afatin e thirrjes ose ta anulojë atë, nëse aplikantët/et nuk përmbushin cilësinë dhe kriteret e kërkuara.